

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE, TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve me objekt: “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë dhe vlerësimin e veprimtarisë ekonomike dhe financiare, për periudhën 01.04.2011-30.09.2012” dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.8, datë 14.02.2013. Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 1102/6, datë 14.02.2013 dërguar Z. *Gazment Dibra, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve*, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i kryer në drejtim të programimit për zbatimin e fondeve buxhetore, u konstatua se: Për vitin 2011 dhe 2012 Ministria e Financave krahas pakësimeve në total të fondeve për DPB, ka pakësuar edhe fondet e çelura në artikullin 602 për 101 milionë lekë. Shkurtimeve të fondeve në këtë zë kanë bërë që, disa kontrata të lidhura dhe të përfunduara të mos likuidohen brenda vitit ushtrimor, duke sjellë si pasojë që, detyrimet të mbarten nga viti në vit dhe për periudhën 9 mujore të vitit 2012 kapin vlerën 110 milionë lekë ose sa dyfishi i vitit 2011. Si rrjedhojë e këtij veprimi, subjektet private kanë kërkuar likuidimin e detyrimeve nëpërmjet vendimeve të gjykatave dhe zyrave përmbarimore. Kjo mënyrë funksionimi, ka sjellë jo vetëm vështirësi në furnizimin me ushqime dhe mallra periudhat pasardhëse por edhe pagimin e kamatëvonesave dhe fitimet e munguara për mos likuidim në afat të detyrimeve, të cilat për periudhën objekt auditimi kapin vlerën prej **2,7 milionë lekë**, me tendencë në rritje për periudhat e ardhshme.

Për këtë rekomandoj që, DPB në projekt buxhetin e vitit 2013 të kryejë detajimin e fondeve buxhetore, duke çelur së pari, fondet për kontratat e palikuiduara nga viti i mëparshëm, po kështu; DPB, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, si organ epror, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, me qëllim që fondet e çelura për kontratat e lidhura për mallra dhe shërbime jetike, sikurse janë ushqimet, medikamentet dhe shërbime të tjera të mos pakësohen, pasi shkurtimi i këtyre fondeve, rrit artificialisht pagimin e kamatëvonesave dhe kushteve penale, me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Në vazhdimësi

2. Nga auditimi i kryer në IEPV Rrogozhinë, për rakordimin e llogarive sintetike të pasivit të bilancit kontabël të vitit 2011, e konkretisht llogaritë 401- 409, dhe 467 me ato analitike, u konstatua se, sipas bilancit detyrimet kreditore ndaj furnitorëve kapin vlerën prej 12,089,822 lekë, në fakt faturat e palikuiduara kapin vlerën prej 15.854.816 lekë, ose më tepër se bilanci për vlerën **3,764,994 lekë**, diferencë e cila përfaqëson detyrime të pakontabilizuara të institucionit. **Për këtë rekomandojmë** që, të bëhet menjëherë sistemimi i aktivitetit dhe i pasivit të bilancit kontabël për vlerën prej 3,764,994 lekë, në mbylljen e vitit ushtrimor 2012.

Menjëherë

3. Nga auditimi i kryer, për zbatimin e buxhetit të DPB dhe realizimit të fondit të pagave, u konstatua se raporti i punonjësve të administratës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me numrin e të burgosurve që trajtohen në të gjitha I EVP, është 1 me 2, pra për çdo 2 të burgosur është 1 punonjës i administratës.

Për këtë rekomandoj, kryerjen e një studimi, me qëllim përqendrimin e disa hallkave administrative në një të vetme, kryesisht për disa Drejtori Rajonale që kanë afërsi territoriale me njëra tjetrën, e konkretisht; Drejtoritë e I EVP Kavajë, Lushnjë, Peqin, Elbasan, apo edhe I EVP Fier, Berat, etj. Kryerja e këtij studimi të ketë për objektiv përqendrimin e stafit drejtues dhe administrativ, me qëllim shkurtimin e numrit të punonjësve dhe të fondit të pagës, kryesisht për punonjësit e administratës, prapavijës dhe të kazermimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve Drejtoria e Burimeve Njerëzore

4. Nga auditimi u kryer për administrimin e mallrave dhe medikamenteve në magazinën e “Spitalit të Burgjeve”, u konstatua se, barnat nuk mbaheshin të sistemuara në raftet përkatëse. Një pjesë e konsiderueshme e tyre ishin skaduar, dhe mbaheshin së bashku me medikamentet në përdorim dhe me afat të gjatë skadence. Nga verifikimi i kryer u gjendën edhe 23 lloje medikamentesh në vlerën prej **1,943,847 lekë** të skaduara që në momentin e dhurimit të tyre, nga shoqëria “Ilma”.

Gjithashtu në depon farmaceutike u gjendën edhe 16 artikuj farmaceutikë në vlerën prej 1,949,579 lekë të skaduara, të cilat ishin të padokumantuara dhe nuk dihej origjina e tyre, nuk ishin inventarizuar, ndonëse ishin kryer disa inventarë gjatë viteve 2006-2010 dhe i fundit i kryer në vitin 2011, trajtuar më hollësisht në faqet 33-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më lart rekomandoj, nxjerrjen jashtë përdorimit, dhe likuidimin e shpenzimeve nga shoqëria donatore “Ilma”, konform ligjit nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, si dhe marrjen e masave për rruajtjen dhe administrimin e barnave konform nenit 3, pika 30 e ligjit të mësipërm. prej 1,943,847 lekë

Menjëherë

5. Nga Auditimi u konstatua se, në muajin shtator 2012, midis DPB dhe ISKSH, është lidhur kontratë e përbashkët për trajtimin shëndetësor ambulator të të sëmurëve me rimbursim nga fondet e buxhetit. Sipas kësaj marrëveshje, për periudhat në vazhdim, DPB furnizimin me barna do ta kryejë nëpërmjet skemës së ISKSH. Ndërsa shërbimi terciar spitalor do të kryhet nëpërmjet procedurave tenderuese që do të kryejë DPB.

Kjo marrëveshje, përfaqëson dy anë të një problemi; njëra anë ka të bëjë me lehtësimin e procedurave tenderuese për blerjen e medikamenteve nga DPB me qëllim; trajtimin dhe shërbimin shëndetësor ambulator të të burgosurve, ndërsa ana tjetër rezulton negative, pasi do të sjellë si pasojë edhe rritje të çmimeve për medikamente, për faktin se, pas shkëputjes së shërbimit ambulator që ka peshë specifike të konsiderueshme në furnizimin me medikamente, do të zhvillohen përsëri procedura prokurimi, por këtë radhe për sasi shumë herë më të pakta.

Për këtë, rekomandoj që, DPB, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, të kryejnë një studim që, shërbimi terciar me barna në spitalin e burgjeve të kryhet nga QSUT, sikurse edhe trajtimi ushqimor në Spitalin e Burgjeve që kryhet nëpërmjet “kateringut” nga QSUT. Nëpërmjet këtij shërbimi do të bëhet e mundur përdorimi më efektiv i fondeve publike.

Brenda datës 30.06.2013

6. Nga auditimi i kryer në disa njësi vartëse, për organizimin e punës për pritjen e produkteve ushqimore të freskëta në zbatim të kontratës së lidhur midis palëve, u konstatua se, marrja në dorëzim e produkteve dhe kolaudimi i tyre është ende një hallkë e dobët, pasi, jo vetëm që nuk respektohet orari i furnizimit, por edhe në aktet e mbajtura nga grupet e kolaudimit, në asnjë rast nuk janë evidentuar mangësi për cilësinë e ushqimeve të furnizuara, si dhe mbritjen e mallrave me vonesë, të dhëna këto, të përcaktuara në kontratat e lidhura midis palëve. Operatori ekonomik ■■■■■ i shpallur fitues për furnizimin e njërive vartëse me produkte ushqimore të freskëta, njëkohësisht është fitues edhe për shumë artikuj të tjerë, që do të thotë se, kapaciteti teknik i tij është i pamjaftueshëm për të përballuar të gjithë kontratat e lidhura për furnizimin e 22 institucioneve në gjithë territorin e vendit me ushqimore të freskëta dhe artikuj të tjerë brenda një orari të caktuar. Nga auditimet e kryera janë konstatuar furnizime të produkteve ushqimore, jashtë orarit të furnizimit dhe me një cilësi të dobët, veprime këto, që jo vetëm krijojnë vështirësi për realizimin e objektivave të DPB, por edhe përfitime të pamenduara nga operatori ekonomik. Duke u nisur edhe nga fakti që DPB ka 22 njësi vartëse të shpërndara në 12 Rajone të vendit, dhe për të përmirësuar gjendjen dhe shmangien e mangësive të konstatuara në furnizimin me produkte të freskëta ushqimore, **rekomandoi që**, në dokumentat e tenderit, krahas kriterëve të përcaktuara për kualifikim, të vendosen edhe kriterë të tjera të veçanta, e konkretisht:

- a. Për produktet blegtorale, të përcaktohen saktë numri dhe mjetet e specializuara dhe të çertifikuara për këtë shërbim;
- b. Të ketë në pronësi magazina grumbullimi dhe dhoma frigoriferike të nevojshme për depozitimin e produkteve ushqimore, për çdo rajon.
- c. Lejë higjieno-sanitare për çdo magazine apo, dhomë frigoriferike;
- d. Të disponojë thertore të liçencuar me të gjithë dokumentacionin sanitar, veterinar dhe mjedisor;
- e. Në mbështetje të kreut VII, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, pika 1 nenkontraktimi, Autoriteti Kontraktor, mund të lejojë nënkontraktimin për realizimin e një pjese të kontratës, duke përcaktuar që, kontraktorët mund t'ia transferojnë kontratën palëve të treta. Autoriteti kontraktor lejon, nënkontraktimin për të nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të vegjël, e të mesëm, por pa tejkalluar 40 % të vlerës së kontratës.
- ë. Gjatë ekzekutimit të kontratës duhet të kontrollojë në se furnizimet dhe dorëzimi i mallrave kryhen nga kontraktori apo nënkontraktorët e autorizuar dhe në se nuk respektohet ky kusht, Autoriteti Kontraktor të përcaktojë vendosjen e sanksioneve ligjore.

Menjëherë

7. Nga auditimi i ushtruar në drejtim të respektimit dhe përdorimit të disa normativave materiale, rezultoi se:

a. Në IEVP Peqin, (një ndër institucionet më të mëdhenj), konsumohen sasi të mëdha uji dhe për likuidimin e faturave mujore shpenzohen fonde të konsiderueshme buxhetore, që variojnë nga 1,000,000 lekë deri 1,200,000 lekë, ose rreth 5 milionë lekë në vit. Ndonëse ky institucion ka një pus, nëpërmjet tij mund të plotësohen deri 50 % e nevojave, por shfrytëzimi i tij është bllokuar pa asnjë argument nga Bashkia, e cila ka në vartësi Ujësjellësin Peqin. Një ndër shkaqet e bllokimit të pusit janë të ardhurat e larta që sigurohen nga shitja e ujit për IEVP Peqin, të cilat shërbejnë për rregullimin e bilancit të pagesave, pasi Ujësjellësi Peqin, ka nivel tepër të ulët të arkëtimeve nga përdoruesit e ujit, familjarë dhe jofamiljarë, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 77-78, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë rekomandojmë, DPB, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Transporteve dhe Rregullimit të Territorit e cila ka në vartësi Ujësjellësin Peqin, të marrin masa

të menjëhershme për shfrytëzimin e pusit, veprim i cili do të sjellë kursimin e fondeve buxhetore për rreth 2,5 milionë lekë në vit.

b. Një tjetër zë shpenzimi që ka peshë specifike të lartë ndaj totalit të shpenzimeve është edhe përdorimi i energjisë elektrike. Nga auditimi i kryer në I EVP vartëse, u konstatuan edhe disa shkaqe që sjellin si pasojë rritjen e konsumit të energjisë elektrike, kështu:

Në listën e produkteve e mallrave të miratuara, dhe që shiten në dyqanet e brendshme të burgjeve janë lejuar të tregtohen edhe artikuj ushqimorë dhe e materiale të ndryshme elektrike. Tregtimi i këtyre artikujve krijon kushte që të burgosurit të gatuajnë ushqime në mënyrë individuale dhe të mos preferojnë kuzhinën e burgut. Ky veprim sjell si pasojë, jo vetëm shpërdorimin e ushqimit edhe përdorimin pa efektivitet të fondeve buxhetore dhe nga ana tjetër, përdorimi i artikujve elektrike për gatim sjell edhe harxhimin pa kriter të energjisë elektrike, trajtuar më hollësisht në faqen nr. 82, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë rekomandoj:

a. Heqjen nga lista e tregtimit në dyqanet e burgjeve të artikujve ushqimorë dhe elektroshtëpiakë me qëllim eliminimin e gatimit të ushqimeve brenda qelive, veprim i cili jo vetëm do sjellë kursimin e energjisë elektrike por edhe përdorimin efektiv të fondeve buxhetore për ushqim.

b. Marrjen e masave, që në projektbuxhetet efatmesme të investimeve të programohen fonde për shfrytëzimin e energjisë diellore, duke pasur si objektiv pajisjen e I EVP me “panelet diellore”.

Menjëherë

8. Nga auditimi u konstatuan se, për periudhën objekt auditimi janë depozituar 35 vendime të Gjykatës së Apelit Tiranë në vlerën prej 42,031 mijë lekë që i përkasin periudhës 2004-2009, nga të cilat janë paguar 15,668 mijë lekë, me objekt “kontrata të papaguara në afat” dhe mosrespektim të procedurave ligjore në fuqi për “largim nga puna”, duke sjellë si pasojë efekte negative për buxhetin e shtetit, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 80-81, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë rekomandoj: marrjen e masave për të siguruar një trajtim të plotë juridik, të fillimit të procedurave për “masa disiplinore”, sipas ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”, “Kodit të Punës”, dhe kontratave kolektiva apo individuale të punës, me qëllim eliminimin e procedurave gjyqësore nëpërmjet të cilave dëmtohen fondet publike.

Menjëherë

B. MASA ZHDËMTIMI

Mbështetur në nenin 27, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Për Kodin e Punës” me ndryshimet e mëvonshme, të kryen kontabilizimet të nxirren urdhrat për shpërblim dëmi, si më poshtë:

1. Të kërkohet në mënyrë ligjore arkëtimi i vlerës **470,000 lekë**, nga [REDAKTUAR] për dëmtimin e një transformatori për shkak të luhatjeve të tensionit në fiderin pronë e [REDAKTUAR] trajtuar më hollësisht në faqen nr. 31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë.

2. Të kërkohet në mënyrë ligjore arkëtimi i vlerës **240,000 lekë**, nga shoqëria [REDAKTUAR] për sa përfituar padrejtësisht në hartimin e projektit të objektit “Paraburgimi i burgut 313”, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 31-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë.

3. Të kërkohet në mënyrë ligjore arkëtimi i vlerës **924,912 lekë**, për sa përfituar padrejtësisht 51 punonjës, si rrjedhojë e llogaritjes së gabuar të shpenzimeve udhëtim e dietë, tatimit mbi pagë dhe sigurimeve shëndetësore, si dhe veprime të tjera të pasakta, trajtuar më hollësisht në faqen nr. 38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe listës bashkëlidhur.

Menjëherë

4. Të kërkohet në mënyrë ligjore arkëtimi i vlerës **283,896 lekë**, nga shoqëria [REDAKTUAR] shpk, për sa përfituar padrejtësisht në objektin “**Rrjet i jashtëm inxhinierik i paraburgimit Elbasan**”, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 42-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

5. Të kërkohet në mënyrë ligjore arkëtimi i vlerës **79,422 lekë**, nga shoqëria “[REDAKTUAR]” shpk, për sa përfituar padrejtësisht në objektin “**Rikonstruksion i soletës së katit të parë dhe përforcimi i murit rrethues në anën veriore të I EVP J.Misja 313 Tiranë**”, trajtuar më hollësisht në faqen nr. 52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

6. Të kërkohet në mënyrë ligjore arkëtimi i vlerës prej **451,000 lekë**, për sa përfituar padrejtësisht punonjësit e I EVP Lezhë, konstatuar nga Sektori i Auditimit të Brendshëm të DPB, por pa marë masa për të rekomanduar arkëtimin e vlerës së përfituar padrejtësisht nga personat përgjegjës, trajtuar më hollësisht në faqen nr. 75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

7. Të kërkohet në mënyrë ligjore arkëtimi i vlerës prej **349,200 lekë**, nga kompania e sigurimeve [REDAKTUAR] për mos respektim të kushteve të kontratës së lidhur me dy operatorë ekonomikë për likuidimin e vlerës 10 % të garancisë së kontratës në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, respektivisht [REDAKTUAR], të cilët kanë ndërprerë në mënyrë të njëanëshme kontratën “furnizim me mallra”, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 54 dhe 58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

8. Të kërkohet në mënyrë ligjore arkëtimi i vlerës prej **305,508 lekë**, nga [REDAKTUAR], për sa xhiruar padrejtësisht dhe në kundërshtim me vendimin e Gjykatës së Apelit nr. 5263, datë 04.11.2004, për zhvendëtimin e sendeve të humbura të shtetasit [REDAKTUAR] trajtuar më hollësisht në faqet nr.81-82, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

9. Të kërkohet në mënyrë ligjore arkëtimi i vlerës prej **305,508 lekë**, nga [REDAKTUAR] për sa xhiruar padrejtësisht dhe në kundërshtim me vendimin e Gjykatës së Apelit nr. 5263, datë 04.11.2004, për zhvendëtimin e sendeve të humbura të shtetasit [REDAKTUAR] trajtuar më hollësisht në faqen nr. 81-82, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

C. MASA ADMINISTRATIVE

Të njoftohet Ministria e Shëndetësisë dhe Qendra e Kontrollit të Barnave, për marrjen e masave administrative deri në heqjen e licencës profesionale të shoqërisë farmaceutike “ILMA” shpk, e cila në kundërshtim me nenin 3, pika 30 e ligjit nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, ka dhuruar barna të skaduara në “Spitalin e Burgjeve” në vlerën prej **1,943,847 lekë**, si dhe pagimin e të gjitha shpenzimeve për nxjerrjen jashtë përdorimit të barnave, konform nenit 59, “Për administrimin dhe asgjësimin e barnave”.

D. MASA DISIPLINORE

D.1. Mbështetur në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, neni 25 pika 3 germa “ç” dhe pikën 1 e 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 306, datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore: “Kalim në një detyrë apo klasë më të ulët për një vit”:

1. ████████, në cilësinë e ish përgjegjës të Sektorit të Financës, dhe aktualisht përgjegjës i financës së “Spitalit të Burgjeve”, pasi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore e konkretisht:

-Për sa kryer veprim kontabël të gabuar për likuidim e shoqërisë farmaceutike “Vinifarma” me vendim të Gjykatës së Apelit, në vlerën prej 7,446,612 lekë, duke debituar llogarinë 602, dhe jo në kredi të llogarisë 401, apo llogarisë 467, si llogari pasive që vërtetojnë gjendjen kreditore të kësaj shoqërie të mbartur prej vitit 2004, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 80-81, të Raportit Përfundimtar të Auditimit;

-Në kundërshtim me vendimin e gjykatës së apelit nr.5263, datë 04.11.2004, ka likuiduar vlerën prej 611 mijë lekë, ndaj një shtetasi, për sendet e humbura në paraburgimin e burgut 313, dhe jo sipas përgjegjësisë direkte të përcaktuar në vendimin e Gjykatës së Apelit, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 81-82, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-Në cilësinë e përgjegjës të financës së “Spitalit të Burgjeve”, ka lejuar dhe pranuar të bëhen hyrje në magazinë medikamente të skaduara, donacion nga shoqëria farmaceutike ████████ në vlerën prej 1,943,387 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 33-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit;

-Në cilësinë e përgjegjës të financës së “Spitalit të Burgjeve”, nuk ka marrë masa për inventarizimin e plotë të vlerave materiale që ndodhen në depon farmaceutike të “Spitalit të Burgjeve”, duke lënë pa inventarizuar 23 medikamente në vlerën prej 1,949,579 lekë, trajtuar më hollësisht në faqen nr. 34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe procesverbaleve nr. 1, datë 23.11.2012 dhe nr. 3, datë 26.11.2012 dhe aktverifikimi nr. 2, datë 30.11.2012.

2. ████████, në cilësinë ish Drejtore e Drejtorisë Ekonomike, meriton masën për largim nga shërbimi civil, por meqenëse është larguar nga detyra nuk rekomandojmë masë disiplinore. Megjithatë rekomandojmë që, DPB të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për ta evidentuar në regjistrin e masave disiplinore.

Drejtorja e Burimeve Njerëzore

D.2. Mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”, me ndryshimet, neni 37, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore: “Vërejtje me paralajmërim” për punonjësit e mëposhtëm:

1. Për ████████, në cilësinë, specialiste dhe përgjegjëse e depos farmaceutike të burgjeve, pasi ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin

farmaceutik”, pasi nuk ka marrë asnjë masë për sistemimin dhe administrimin e barnave konform, udhëzimit të Ministrisë së shëndetësisë “Për rregullat e administrimit dhe të mirëmbajtjes së medikamenteve farmaceutike”,

-Ka pranuar dhe administruar medikamente farmaceutike pa dokumentacionin përkatës, si dhe nuk ka deklaruar gjendjen e tyre gjatë kryerjes së inventarëve në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 30.04.2007 “Për kontabilitetin”, si dhe nuk ka marrë asnjë masë për të informuar Sektorin e Shëndetësisë, për marrjen e masave për shpërndarjen e tyre.

-Në cilësinë e përgjegjësese materiale nuk ka marrë masa për inventarizimin e plotë të vlerave materiale që ndodhen në depon farmaceutike të “Spitalit të Burgjeve”, duke lënë pa inventarizuar 23 artikuj farmaceutike në **vlerën prej 1,949,579 lekë** në kundërshtim me ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, trajtuar më hollësisht në faqet nr, 33-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, dhe procesverbalit nr. 3, datë 30.11.2012.

[REDAKTUAR], në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në IEPV Rrogozhinë, kanë vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik’ i ndryshuar, pasi në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë për tenderin “furnizim me produkte ushqimore dhe blegtorale”, ofertat e paraqitura nuk i kanë vlerësuar dhe klasifikuar në kushte të barabarta, e për rrjedhojë kanë shpallur fitues operatorin ekonomik, i cili ka paraqitur ofertën me më pak artikuj sa janë parashikuar në dokumentat e tenderit hartuar nga Autoriteti Kontraktor”, trajtuar më hollësisht në faqet nr, 72-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe aktverifikimit nr. 3, datë 30.11.2012.

7. [REDAKTUAR], në cilësinë e shefit të prapavijës në IEPV Lushnjë;

8. [REDAKTUAR] në cilësinë e Përgjegjësese së Sektorit të Financës në IEPV Lushnjë, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës, kanë vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, pasi tejkalimi i shpenzimeve në disa zëra, ka sjellë si pasojë mos likuidimin e disa kontratave të lidhura për furnizim me produkte ushqimore. Këto mangësi tregojnë, jo vetëm përdorimin pa efektivitet të fondeve buxhetore, por nga ana tjetër krijojnë kushte që operatorët ekonomikë t’i drejtohen gjykatës, për të arkëtuar vlerën e palikuiduar por edhe sanksione të tjera ligjore të parashikuara në kontratën e lidhur midis palëve, me pasojë dëm ekonomik për fondet buxhetore trajtuar më hollësisht në faqet nr, 72-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe aktverifikimit nr. 3, datë 30.11.2012.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Andrea Kristo Përgjegjës Grupi, Kujtim Rama, Valentina Sulo, Nerënxa Llapashtica dhe Mina Blushi. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit zj. Luljeta Nano, Drejtori i Departamentit z. Ded Trieshi dhe Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT